



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

PRISHTINE

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPK Nr. Prot. 03-03/4512/16
 Nr. I tag 02 Datum 02-12-2016
 Nr. pages 02 Date 02-12-2016

DATË/A:	02/12/2016
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Gzim KLLOKOQI Zyrtar i Prokurimit në Universitetin e Gjilanit "Kadri Zeka"
CC:	z. Vaxhid SADRIU Sekretar i Përgjithshëm në Universitetin e Gjilanit "Kadri Zeka"
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Shërbimet e internetit dhe VPN "

I nderuari z. Kllokoqi,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " **Shërbimet e internetit dhe VPN**", me numër prokurimi: KZ 16 006 221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Shërbimet e internetit dhe VPN**", me numër prokurimi: KZ 16 006 221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Universiteti i Gjilanit, përmes zyrës së prokurimit ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull "**Shërbimet e internetit dhe VPN**", me numër prokurimi: KZ 16 006 221i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.14/11/2016. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në fushën e Prokurimit Publik (DPKPP) sipas detyrës zyrtare ka identifikuar dhe trajtuar këtë procedurë të prokurimit. Gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi, AKK ka hasur në disa dhëna të cilat nuk janë në pajtim me Legjislacionin në fuqi Prokurimit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e ofruar nga ana e Autoritetit kontraktues ka konstatuar faktet si në vijim:

Në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit e cila është përgatitur nga ana e Autoritetit Kontraktues, tek rubrika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional te pika 1 është kërkuar: Pasqyra e projektit dhe vlera minimale referencë në lidhje me punët në tri vitet e fundit, dëshmia e kërkuar: Lista e kontratave kryesore ose referencat relevante të shërbimeve të operatorit ekonomik të realizuara gjatë 3 viteve të kaluara, (Ndërmarrja që merr pjesë në këtë tender duhet të dëshmoj se ka ekzekutuar me sukses së paku 1 (një) kontratë të ngjashme me këtë tender me institucionet publike). Kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se është diskriminuese dhe kufizon konkurrencën e lire në mesin e Operatorëve Ekonomik.

Sipas LPP-së Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkoj kontrata dhe referenca për furnizime që ka realizuar Operatori ekonomik me institucionet publike, misionet ndërkombëtare dhe private, mirëpo nuk është e lejuar që të kërkohen kontrata vetëm me institucionet publike.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 69 Aftësitë Teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon korrigjimin e gabimeve të kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !